REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1093/20
Datë/Datum. 12.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1093/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Studio Links 4" Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A", me numër të E-prokurimit: TER 020-030-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P "Termokos" Sh.A, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Studio Links 4" Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A" , me numër të E-prokurimit: TER 020-030-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P "Termokos" Sh.A.

II. ANULOHET, njoftimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikëqyrja e objektit te ri Administrativ dhe objekteve përcjellëse te N.P Termokos SH.A" , me numër të E-prokurimit: TER 020-030-2-2-1, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –N.P "Termokos" Sh.A, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

AK ka mundur dhe eshte dashtur te konsumoj Nenin 72 per te kerkuar deshmi shtese ne kete rast trustin pensional per secilin ekspert.

Prandaj sipas rekomandimitte OSHP-se AK ka bere shkelje kur nuk ka perfillur rekomandimin e OSHP-se per konsumim te nenit 59.2 dhe72, por duke bere tentim per venie ne lajthitje ka bere tentim konsumim te nenit 72 me kerkesen per zgjatje te afatit te vlefshmerise se Sigurimit te ofertes. Sigurimi i ofertes nuk ka qene pike e kontestuar dhe per te cilen ka vendosur OSHP, prandaj AK PRAP ka bere shkelje duke mos u thirre ne nenin 72 per pikat e kontestuara.

Neni 59.2 i LPP te cilin e urdheron OSHP tek ky vleresim tenderi eshte:

Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

SIGURIMI I OFERTES ne asnje rast nuk ka ndihmuar krahasimin vleresimin apo ekzaminimin e tendereve. AK ben shkelje ligjore dhe tentim lajthitje.

Ne vleresimin e pare OE STUDIO LINKS 4 ka qene i pergjegjshem por AK ka kontestuar vetem cmimin ndersa tani del se OE nuk i ka ekspertat ne rregull. AK nuk eshte konsistent."

Duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndes eksperti shqyrtues konstaton se AK ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsytimin se:

"1.Sipas komisionit te Vlersimit te tenderve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotsuar kete kerese te Dosjes se Tenderit stafi i prenzantuar nga ana juaj nuk plotesone kerkesen , qe ka qene kriter ne Njoftim per kontrat dhe ne DT.

2. Sipas komisionit te Vlersimit te tenderve pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2 O.E "Studio Links 4" nuk ka ofruar deshmi te mjaftueshem per njerin inxhinier te elektroteknikes pasi qe kerkes ne DT ka qene inxhinier i Elektro teknikes me pervoje pune 10 vjeqare Z.Dukaxhin Ramosaj i prezantuar nga O.E si inxhinier i elektro teknikes ne diplomen e prezantuar shkraun se me date 28 dhjetor 2015 ka mbaruar studimet master ne Universitetin "Hasan prishtina" dhe mori titullin Master i Shkencave te inxhinieris Elektrike. Andaj ne baze te kesaj inxhinieri i prezantuar ka vetëm 4 vite përvoje punësi inxhinier dhe nuk permbushe kriteret e kerkuara ne Njoftim per Kontrat dhe ne Dosje te Tenderit.

3. Sipas komisionit te Vlerësimit te tenderëve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE,

NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotsuar kete kerese te Dosjes se Tenderit stafi i prenzantuar nga ana juaj nuk plotesone kerkesen , qe ka qene kriter ne Njoftim per kontrat dhe ne DT."

Ndërsa AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit lidhur me stafin e lartë cekur ka parashtruar kërkesat dhe dëshmitë si vijon:

Kërkesat:

Kërkesa 4: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2

Kërkesa 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Kërkesa 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dëshmit e kërkuara:

Dëshmia 4: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA.**

Dëshmia 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA.**

Dëshmia 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA**.

Ndersa OE ankuese se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listen me të dhënat e stafit, në këtë listë përveq të dhënave të stafit tjeter:

1. Nën numrin rendor 3 ka paraqitur z.Dukagjin Ramqaj ne cilesin e inxhinierit te diplomuar te elektroteknikës si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontrates se punes, CV, kopjen e diplomes te vertetuar tek noteri te leshuar në vitin 2009 nga Univirsiteti i Prishtines me te cilen deshmohet se i njejti ka mbaruar studimet bachelor i inxhinieris elektrike me 07 nentor 2008, kopjen e diplomes te vertetuar tek noteri te leshuar në vitin 2016 nga Univirsiteti i Prishtines me te cilen deshmohet se i njejti ka mbaruar studimet master i inxhinieris elektrike me 28 dhjetor 2015, dy leter referencat te leshuara nga "Mabetex group" ne vitin 2011 dhe 2018, leter referencen e lëshuar nga "Euro Invest" ne vitin 2017, leter referencen e lëshuar nga "NNP Studio Links 4 " ne vitin 2018 si dhe me rastin e parashtrimit te ankeses në OSHP, OE ankuese ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga

TRUSTI në bazë të të cilave dëshmohet se z.Dukagjin Ramqaj ka përvoj pune nga viti 2008 deri në nentor të vitit 2020.

2. Nën numrin rendor 7 ka paraqitur zonj.Luljeta Hoxha-Osmani ne cilesin e inxhiniers se diplomuar te Arkitekturës-Auditor i energjisë, ekspertë i efiçiencës së energjisë, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontrates se punes, CV, kopjen e diplomes te vertetuar tek noteri- te leshuar në vitin 2004 nga Univirsiteti i Prishtines me te cilen deshmohet se i njejti ka mbaruar studimet për inxhinier te diplomuar te Arkitekturës me 14.06.2004, dy leter referencat te leshuara nga "NNP Studio Links 4" ne vitin 2013 dhe 2017, leter referencen e lëshuar nga "exerga" ne vitin 2019, leter referencen e lëshuar nga "LDK construction engineers and plammers S.A" ne vitin 2015, leter rekomandim te leshuar nga "gtz" për vitin 2007 si dhe me rastin e parashtrimit te ankeses në OSHP, OE ankuese ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga TRUSTI në bazë të të cilave dëshmohet se zonj.Luljeta Hoxha-Osmani ka përvoj pune nga viti 2004 deri në vitin 2020.
3. Nën numrin rendor 9 ka paraqitur zonj.Lumnije Gashi-Shabani ne cilesin e inxhinierse se diplomuar te Arkitekturës- eksperti i mjedisitë, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontrates se punes, CV, kopjen e diplomes te vertetuar tek noteri- te leshuar në vitin 2002 nga Univirsiteti i Prishtines me te cilen deshmohet se i njejti ka mbaruar studimet për inxhinier te diplomuar te Arkitekturës me 10.11.2000, kopjen e licences nr.45/19 per hartimin e raporteve VNM-së të lëshuar nga MMPH te vertetuar tek noteri, kopjen e certifikates për kryrjen e kursit ne planifikimin dhe menaxhimin urban te leshuar nga UN ne vitin 2003, kopjen e certificates se Masterit te leshuar ne vitin 2005 nga "IHC", Universiteti Erasmus Roterdam, kopje te certifkatave te leshuara nga IHC ne vitin 2002 dhe 2003, kopjen e certifikates të lëshuar nga "Riinvest", kopjen e certificates te leshuar nga "Gisdata" ne vitin 2003, kopjen e certificates te leshuar nga UNDP ne vitin 2010, leter referencat te leshuara nga "NNP Studio Links 4" ne vitin 2015 si dhe me rastin e parashtrimit te ankeses në OSHP, OE ankuese ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga TRUSTI në bazë të të cilave dëshmohet se zonj. Lumnije Gashi-Shabani ka përvoj pune nga viti 2002 deri në vitin 2020.

Bazuar në faktet e lartëcekura eksperti shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk e ka zbatuar në tërësi rekomandimin e dalur me vendimin e OSHP-së PSH 803,820 te dates 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave sepse OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dëshmi të mjaftushme konform kërkesave të parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me, inxhinierin e diplomuar te elektroteknikës, inxhinierin e energjis efiqiente dhe ekspertin e licencuar për ndikim në mjedis. Nese AK i ka pas të paqarta dëshmit e dorëzuar nga OE ankues, atëherë ka qenë dashur që të marr për bazë rekomandimin e dalur me vendimin e OSHP-së PSH 803, 820 te dates 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2

dhe 72 të LPP-së, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave dhe të kërkoj sqarime para se të marr vendim që ta eliminoj. Andaj pretendimi i lartë cekur i OE ankues **është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 130 të LPP-së, me arsyetimin se:

Nga shkresat e OE LINKS 4, derguar AK jeni njoftuar per VEPREN PENALE FALSIFIKIM E CILA sipas Kodit penal te Kosoves eshte e denueshme me ligj nga 1 deri 8 vjet burg.

AK pas dorezimit të kërkesës per rishqyrtim nga ana e OE LINKS, 4 ka bere rishqyrtim te vendimit dhe ka perfunduar se se dokumentet të cilat LINKS 4 i ka paraqitur si të falsifikuara, në të vërtetë nuk janë të tilla. Lënda ka shkuar në OSHP, ku OSHP vetëm se ka konfirmuar se dokumentet e tilla janë të falsifikuara dhe një gjë e tillë është lëshuar në vendim të OSHP-së.

Tani AK në vendimin e fundit bënë fshehjen e kësaj VEPRE PENALE të dënueshme me LIGJ dhe me qëllim të mbrojtjes së stafit dhe personelit të Ndërmarrjes Termokos të cilët kanë bërë shkelje të LPP Neni 130, në vendimin e fundit FARE NUK E PËRMEND VEPREN FALSIFIKIM të OE ARHING.

Andaj duke cituar LPP dhe Nenin 130: 1. Çdo nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i autoritet kontraktues që vihet në dijeni, përmes çfarëdo mjeti, për veprën e përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni ose për ndonjë rast që pritet të përfshijë një vepër të tillë, menjëherë duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme.

AK – ka bere tentim per fshehjen e vepres penale dhe kjo denohet me ligj sipas KODI PENAL i KOSOVES Neni 390 pika 3."

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se OE ankuese pretendimet ne fjale vetem i ka cekur siperfaqsisht në ankes pa sqaruar dhe pa dhenë ndonjë fakt apo dëshmi se cilat dokumentacione i ka falsifiku OE "Arhing", po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave operatorin ekonomik "Arhing" e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsytimin se e njejta është e papergjegjshme. Lidhur me pretendimet për falsifikim të dokumenteve, OE ankuese, mund t'i drejtohet organeve kompetente.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues "Studio Links 4",Prishtine të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndersa të anulohet vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit te prokurimit si dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues me datë 30.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues per arsyen e eliminimit te OE ankues dhe ju lutemi qe te shikoni letrenstandarde per tenderuesin e eliminuar Studio Lings dhe te bëni krahasimin pasi qe OE nuk i plotëson kërkesat e AK te saktësuara ne Njoftim për kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit, AK ka respektuar vendimin e OSHP-së pasi qe kemi kthyer lenden ne rivlerësim dhe kemi eliminuar OE Arhing si ofertë e pa përgjegjshme konform vendimit te OSHP-së siqe shihet edhe ne raportin e vlerësimit te tenderëve te rekomanduar nga Komisioni Vlerësues . dhe ju lutemi qe te merren ti gjitha masat ndëshkuese komfore dispozitave te LPP-së ndaj OE Arhing per prezantimin e dokumenteve fiktiv, qe eshte munduar ti sjell ne lajthitje AK.

Operatori ekonomik me datë 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Studio Links 4" Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 72 të LPP-së, konkretisht duke pretenduar se mos konsumimi i nenit 72 dhe 59.2 dhe shkelje e nenit 59 të LPP-së, pasi që AK ka mundur dhe është dashur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së për përvojën e stafit dhe trustit pensional. OE ankues shton se: sipas rekomandimit të OSHP-së, AK ka bërë shkelje kur nuk ka përfillur rekomandimin e OSHP-së duke bërë tentim për vënie në lajthitje me kërkesën për zgjatje të afatit të vlefshmërisë së sigurimit të ofertës. Sigurimi i ofertës nuk ka qenë pikë e kontestuar dhe për të cilën ka vendosur OSHP, prandaj AK përsëri ka bërë shkelje duke mos u thirr në nenin 72 për pikat e kontestuara.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK e ka eliminuar operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se:

"1.Sipas komisionit të vlerësimit të tenderëve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Inxhinier i energjisë së efiçencës me përvojë 5 vjeçare, në lëmi të njëjtë numri i stafit -1 nuk keni plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, që ka qenë kriter në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

2. Sipas komisionit të vlerësimit të tenderëve pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2 O.E "Studio Links 4" nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njërin inxhinier të elektroteknikes pasi që kërkesë në dosje të tenderit ka qenë inxhinier i Elektro teknikes me përvojë pune 10 vjeçare z. Dukaxhin Ramosaj i prezantuar nga OE si inxhinier i elektro teknikës në diplomën e prezantuar shkruan se me datë 28 dhjetor 2015 ka mbaruar studimet master ne Universitetin "Hasan Prishtina" dhe mori titullin Master i Shkencave të inxhinierisë elektrike. Andaj në bazë të kësaj, inxhinieri i prezantuar ka vetëm 4 vite përvoje punësi inxhinier dhe nuk përmbush kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

3. Sipas komisionit të vlerësimit të tenderëve pika .III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 nuk keni plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën që ka qene kriter në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit."

Ndërsa AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit lidhur me stafin e lartë cekur ka parashtruar kërkesat dhe dëshmitë si vijon:

Kërkesat:

Kërkesa 4: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2

Kërkesa 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Kërkesa 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dëshmit e kërkuara:

Dëshmia 4: INXHINIER ELEKTROTEKNIKËS ME PËRVOJË 10 VJEÇARE, (INXHINIER TË DIPLOMUAR DHE SPECIALIST TË FUSHËS) NUMRI I STAFIT -2 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA.**

Dëshmia 8: INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA.**

Dëshmia 10: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 TE PREZANTOHET DIPLOMA

ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL **OSE DESHMI TJERA**.

Kurse, OE ankues së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën me të dhënat e stafit, në këtë listë përveç të dhënave të stafit tjetër:

1. Në numrin rendor 3 ka paraqitur z. Dukagjin Ramqaj në cilësinë e inxhinierit të diplomuar të elektroteknikës si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontratës së punës, CV, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri të lëshuar në vitin 2009 nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet bachelor i inxhinierisë elektrike me 07 nëntor 2008, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri të lëshuar në vitin 2016 nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet master i inxhinierisë elektrike me 28 dhjetor 2015, dy letër referencat të lëshuara nga "Mabetex group" në vitin 2011 dhe 2018, letër referencën e lëshuar nga "Euro Invest" në vitin 2017, letër referencën e lëshuar nga "NNP Studio Links 4" në vitin 2018, si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, OE ankues ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga trusti në bazë të të cilave dëshmohet se z. Dukagjin Ramqaj ka përvojë pune nga viti 2008 deri në nëntor të vitit 2020.
2. Në numrin rendor 7 ka paraqitur zonj. Luljeta Hoxha-Osmani në cilësinë e inxhinieres së diplomuar të Arkitekturës-Auditor i energjisë, ekspertë i efiçiencës së energjisë, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontratës së punës, CV, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri- të lëshuar në vitin 2004 nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet për inxhinier të diplomuar të Arkitekturës me 14.06.2004, dy letër referencat të lëshuara nga "NNP Studio Links 4" në vitin 2013 dhe 2017, letër referencën e lëshuar nga "exerga" në vitin 2019, letër referencën e lëshuar nga "LDK construction engineers and plammers S.A" në vitin 2015, letër rekomandim të lëshuar nga "gtz" për vitin 2007 si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, OE ankues ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga TRUSTI në bazë të të cilave dëshmohet se zonj. Luljeta Hoxha-Osmani ka përvojë pune nga viti 2004 deri në vitin 2020.
3. Në numrin rendor 9 ka paraqitur zonj. Lumnije Gashi-Shabani në cilësinë e inxhinieres së diplomuar të Arkitekturës - eksperti i mjedisit, si dhe ka bashkangjitur kopjen e kontratës së punës, CV, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri- te lëshuar në vitin 2002 nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se i njëjti ka mbaruar studimet për inxhinier të diplomuar të Arkitekturës me 10.11.2000, kopjen e licencës nr.45/19 për hartimin e raporteve VNM-së të lëshuar nga MMPH të vërtetuar tek noteri, kopjen e certifikatës për kryerjen e kursit në planifikimin dhe menaxhimin urban të lëshuar nga UN në vitin 2003, kopjen e certifikatës së Masterit të lëshuar në vitin 2005 nga "IHC", Universiteti Erasmus Roterdam, kopje të certifkatave të lëshuara nga IHC në vitin 2002 dhe 2003, kopjen e certifikatës të lëshuar nga "Riinvest", kopjen e certificatës të lëshuar nga "Gisdata"

në vitin 2003, kopjen e certificatës të lëshuar nga UNDP në vitin 2010, letër referencat të lëshuara nga "NNP Studio Links 4" në vitin 2015, si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, OE ankues ka dorëzuar pasqyrat e llogarisë të lëshuar nga TRUSTI në bazë të të cilave dëshmohet se zonj. Lumnije Gashi-Shabani ka përvojë pune nga viti 2002 deri në vitin 2020.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, duke u bazuar në faktet e lartë cekura, konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave nuk e ka zbatuar në tërësi rekomandimin e OSHP-së sipas vendimit PSH.nr.803-820/20 të datës 13.11.2020, ku është konstatuar që AK duhet të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave sepse OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme konform kërkesave të parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës, inxhinierin e energjisë efiqiente dhe ekspertin e licencuar për ndikim në mjedis. Nëse AK i ka pas të paqarta dëshmitë e dorëzuar nga OE ankues, atëherë ka qenë dashur që të marr për bazë rekomandimin e OSHP-së sipas vendimit PSH.nr.803-820/20 të datës 13.11.2020 që të zbatoj nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave dhe të kërkoj sqarime para se të marr vendim që ta eliminoj. Andaj pretendimi i lartë cekur i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "Studio Links 4" Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 130 të LPP-së, me arsyetimin se nga shkresat e OE LINKS 4, ku AK me rastin e rishqyrtimit të vendimit ka ardhë në përfundim se OE ankues ka paraqitur dokumente të falsifikuara, në të vërtetë nuk janë të tilla. OE ankues në vazhdim të pretendimit cek: Tani AK në vendimin e fundit bënë fshehjen e kësaj VEPRE PENALE të dënueshme me LIGJ dhe me qëllim të mbrojtjes së stafit dhe personelit të Ndërmarrjes Termokos të cilët kanë bërë shkelje të LPP Neni 130, në vendimin e fundit FARE NUK E PËRMEND VEPREN FALSIFIKIM të OE ARHING. Andaj duke cituar LPP dhe Nenin 130: 1. Çdo nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i autoritet kontraktues që vihet në dijeni, përmes çfarëdo mjeti, për veprën e përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni ose për ndonjë rast që pritet të përfshijë një vepër të tillë, menjëherë duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme. AK – ka bere tentim për fshehjen e veprës penale dhe kjo dënohet me ligj sipas KODI PENAL i KOSOVES Neni 390 pika 3."

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE ankues pretendimet në fjale vetëm i ka cekur sipërfaqësisht në ankesë pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt apo dëshmi se cilat dokumentacione i ka falsifikuar OE "Arhing". Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave, operatorin ekonomik "Arhing" e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se e njëjta është e pa përgjegjshme. Kurse, sa i përket pretendimit të OE ankues në lidhje me falsifikim të dokumenteve, Paneli Shqyrtues e udhëzon palën që ti drejtohet organeve kompetente të cilat merren me ndjekjen e personave të cilët kryejnë vepër penale, që në rastin konkret lidhet me pretendimin e

OE ankues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues dhe rekomandimeve të ekspertit profesional, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, Po ashtu, Paneli Shqyrtues në vendimin paraprak e ka udhëzuar autoritetin kontraktues që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së mirëpo AK nuk ka zbatuar këtë konstatim. Andaj, detyrohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë vlerësimin e ofertave në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Në të kundërt, nëse AK nuk përfill në përpikëri vendimet e Panelit Shqyrtues, AK e detyron Panelit Shqyrtues që të ndërmerr masa konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "N.P Termokos Sh.A";

1x1 OE "Studio Links 4",Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.